

# Deklaratë për bibliotekat dhe lirinë intelektuale

*Miraturar nga kryesia e IFLA-s më 25 mars të vitit 1999 në Haag, Hollandë.*

[Alarabia](#), [Balgarski](#), [Bangla](#), [Bosanski](#), [Cesky](#), [Chaltibhasa](#), [Dansk](#), [Deutsch](#), [English](#), [Español](#), [Farsi](#), [Français](#), [Hangul](#), [Hrvatski](#), [Íslenska](#), [Italiano](#), [Kartuli](#), [Lietuviskaj](#), [Magyar](#), [Nederlands](#), [Nihongo](#), [Norsk](#), [Polski](#), [Português](#), [Russkij](#), [Srpski](#), [Suomeksi](#), [Svenska](#), [Tagalog](#), [Tamil](#), [Türkçe](#), [Viet](#), [Zhongwen](#) (simplified), [Zhongwen](#) (traditional)

IFLA (Federata Ndërkombëtare e Bibliotekave) mbështet, mbron dhe nxit lirinë intelektuale të shpallur nga Kombet e Bashkuara në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut.

IFLA deklaron se qeniet njerëzore kanë të drejtë themelore për akses në dije, mendimin krijues dhe veprimtarinë intelektuale si dhe për të shprehur publikisht mendimet e tyre.

IFLA beson se e drejta për dije dhe liria e shprehjes janë dy anë të të njëjtit parim. E drejta për dije është një domosdoshmëri për lirinë e mendimit dhe të ndërgjegjes; liria e mendimit dhe liria e shprehjes janë kushte të nevojshme për lirinë e shfrytëzimit të informacionit.

IFLA pohon se angazhimi për lirinë intelektuale është një përgjegjësi themelore në fushën e bibliotekave dhe të informacionit.

IFLA, për këtë arsye, u bën thirrje bibliotekave dhe stafit të tyre që t'u përmbahen me vendosmëri parimeve të lirisë intelektuale, aksesit të lirë në informacion dhe lirisë së mendimit si dhe të ruajnë fshehtësinë (konfidencën) e përdoruesve të bibliotekave.

IFLA porositi që veprimtaria e antarëve të saj të nxitë pranimin dhe realizimin e këtyre parimeve. Duke vepruar në këtë mënyrë, IFLA shpall se:

- Bibliotekat sigurojnë akses në informacion, ide dhe krijimtari. Ato shërbejnë si porta të diturisë, të mendimit dhe të kulturës.
- Bibliotekat japin një ndihmë mjaft të rëndësishme për të mësuarin gjatë gjithë jetës, pavarësinë e marrjes së vendimeve dhe zhvillim kulturor të individëve dhe të bashkësive.
- Bibliotekat japin ndihmesën e tyre për zhvillimin dhe mirëadministrimin e lirisë intelektuale si dhe për ruajtjen e vlerave themelore demokratike dhe të të drejtave universale të qytetarëve.
- Bibliotekat sigurojnë dhe të lehtësojnë aksesin në dije dhe veprimtarinë intelektuale. Për këtë, bibliotekat grumbullojnë, ruajnë dhe shërbejnë një llojshmëri të gjerë materialesh që pasqyrojnë pluralitetin dhe diversitetin e shoqërisë.
- Bibliotekat sigurojnë që përzgjedhja dhe shfrytëzimi i materialeve dhe i shërbimeve bibliotekare të bëhen mbi konsiderata profesionale dhe jo mbi kritere politike, morale dhe fetare.
- Bibliotekat grumbullojnë, organizojnë dhe propagandojnë lirisht materialet e tyre si dhe kundërshtojnë çdo formë të censurës.
- Bibliotekat venë për shfrytëzim të barabartë për të gjithë përdoruesit mjetet dhe shërbimet e tyre. Nuk lejohet asnjë formë diskriminimi për shkak të racës, bindjes, gjinisë, moshës apo ndonjë arsyeje tjetër.
- Përdoruesit e bibliotekave kanë të drejtën e konfidencës dhe të anonimatit. Bibliotekarët dhe stafi tjetër bibliotekar nuk duhet t'i zbulojnë një pale të tretë identitetin e përdoruesve ose materialet që ata shfrytëzojnë.
- Bibliotekat që financohen me fonde publike dhe shfrytëzohen nga publiku u përmbahen në veprimtarinë e tyre parimeve të lirisë intelektuale.
- Bibliotekarët dhe të punësuarit e tjerë në bibliotekat e mësipërme kanë për detyrë t'i respektojnë këto parime.
- Bibliotekarët dhe stafi tjetër profesional i bibliotekave realizojnë përgjegjësitë e tyre ndaj punëdhënësve dhe ndaj përdoruesve. Në rastet kur ka mospërputhje midis këtyre dy lloj përgjegjësive, detyra ndaj përdoruesve merr

përparësi.